

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**GJYKATA THEMELORE DIBËR**

**Agj nr. 04-42/2023**

**25.12.2023**

**DIBËR**

Kryetari i Gjykatës Mersim Marku, në përputhje me nen. 88 të Ligjit për Gjykata (“G. Zyrtare e RM” nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe “Gazeta Zyrtare RMV” nr. 96/2019) dhe nen.112 të Rregullores Gjyqësore (“Gazeta Zyrtare RM” nr. 66/2013, 114/2014), pas mendimit paraprak nga mbledhja së gjykatësve datë 25.12.2023, me datë 25.12.2023 e vërtetoi këtë:

**S I S T E M I M**  
**PËR PUNËN E GJYKATËSVE DHE TË PUNËSUARVE**  
**NË GJYKATËN THEMELORE DIBËR PËR VITIN 2024**

Me këtë sistemim për punën e Gjykatës Themelore Dibër për vitin 2024, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit të Gjykatës, gjyqtarëve, nëpunësve gjyqësorë dhe policisë gjyqësore, për kryerjen me sukses të detyrave të punës që rrjedhin nga kompetenca e Gjykatës.

**I.**

**KRYETARI I GJYKATËS**

Kryetari i Gjykatës e përfaqëson Gjykatën, organizon punën dhe ndërmerr masa për kryerjen në kohën e duhur dhe me rregull të punëve në gjykatë, kujdeset për zbatimin konsistent të dispozitave të Rregullores Gjyqësore, kujdeset për kryerjen e punëve në mënyrë të rregullt, efikase dhe azhure nga administrata gjyqësore. Bën mbikqyrjen e sektorëve gjyqësor, të shkrestarisë dhe shërbimeve të tjera, me kontrollimin e regjistrave, afateve kohore dhe evidencave të tjera në gjykatë.

Kryetari i Gjykatës do t'i kryejë edhe detyrimet të cilat dalin nga ligjet dhe Rregullorja Gjyqësore.

**-Adminstrata gjyqësore**

Pasi gjykata nuk ka administrator, Kryetari i Gjykatës do të veprojë sipas të gjitha lëndëve që regjistrohen në regjistrat nga administrata gjyqësore. (AGJ, AGJ-O1, AGJ-02, AGJ-03; AGJ-04, AGJ-05, AGJ-06, AGJ-, AGJ-DOV, AGJ- STR-DOV; UPP, SPI).

Sipas nevojës do të veprojë edhe në lëndët e tjera dhe gjithashtu do të ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat në pajtim me Rregulloren Gjyqësore bëjnë pjesë në fushëveprimin e punës së Kryetarit të Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës do të veprojë edhe sipas lëndëve – Vërtetime (ZAV, ZAV1, ZAV-S, ZAV-H) - shpërndarja automatike në AKMIS.

Si Zëvendës i Kryetarit të Gjykatës në vitin 2024 përcaktohet gjyqtari Oruç Abazovski i cili do të zëvendësojë kryetarin në rast të mungesës së tij.

Personi për marrëdhënie me publikun është Kryetari i Gjykatës, gjyqtari Mersim Marku.

Në rast të mungesës së kryetarit të gjykatës dhe të zëvendësit të kryetarit, në punët urgjente e zëvendëson gjykatësi kujdestar sipas Sistemimit për kujdestari të gjykatësve në gjykatë.

## II.

### **SISTEMIMI I PUNËS SË GJYKATËSVE SIPAS REGJISTRIT**

Gjatë vitit 2024 gjyqtarët në Gjykatën Themelore Dibër do të punojnë sipas sistemimit vijues për punë.

#### **Kryetari i Gjykatës, Gjyqtari Mersim Marku do të veprojë sipas lëndëve dhe atë:**

-Konteste kontestimore (regjistrat: P1, P2, P3, P4, RO, POPOV, MLVP, MVPOV dhe RP) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Përmbarrim – (regjistrat: PPNI, PI, IDS, dhe IZS) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Njohja e vendimit të jashtëm – PSO.

-Lëndë jashtëkontestimore – (regjistra: VPP, VPP1, VPP2; ODS, IPK, RVPP) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Gjatë kujdestarisë sipas lëndëve kundërvajtëse – regjistra: PRK-S, PRK-J, PRK-O, PRK-R, dhe lëndë penale të procedurës paraprake – regjistri KPP.

Në rast të mungesës dhe pamundësisë të Gjyqtarit Mersim Marku që të veprojë sipas lëndëve për të cilat është përcaktuar, për të njëjtat do të veprojë gjyqtari Damjan Iloski.

#### **Gjyqtari Damjan Iloski do të veprojë sipas lëndëve vijuese:**

-Lëndë kontestimore (regjistrat: P1, P4, P.5, PL, PL1, PL1-P, PPOV, ROPOV; PLPOV, MVPOV; MALBV, MALVPL-1, RP, RRO, RPL) - shpërndarja automatike në AKMIS.

-Lëndë jashtëkontestimore (regjistrat: VPP, VPP1, VPP2, ODS, IPK, O, O1, ONAD, RVPP), - shpërndarja automatike në AKMIS.

-Kërkesa (regjistrat: POM dhe ZAM-S dhe ZND) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Si anëtar i Këshillit Penal jashtë shqyrtimit kryesor.

-Sipas nevojës do të veprojë edhe në lëndë të tjera nga të gjitha lëmitë (lëndë penale dhe civile) në të cilat lëndë për arsye të justifikuara nuk mund të veprojnë gjyqtarët e tjerë në Gjykatën Themelore Dibër.

**Gjyqtari Oruç Abazovski** do të veprojë sipas lëndëve vijuese:

-Lëndë penale (regjistra: K-PP, KNZD, K, KR, ZAM-K, KS, KSP, KS-KR, KP, KUK, EK, UO, KPOV) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Lëndë kundërvajtëse (regjistra: PRK-S, PRK-J, PRK-O, PRK-R, PRK-POV) – shpërndarja automatike në AKMIS.

-Përmbarimi i sanksioneve (regjistra: KUIKP, IKP, IPRK, PK, ISAM, IOIP) shpërndarja automatike në AKMIS.

-Vërtetime (ZAV, ZAV1, ZAV-S, ZAV-H) –shpërndarje automatike në AKMIS.

-Si anëtar i Këshillit Penal jashtë shqyrtimit kryesor (nen.25 parag.5 të LPP).

-Sipas lëndëve në të gjitha lëmitë gjatë kujdestarisë pas përfundimit të orarit të punës, në pajtim me Sistemimin për Kujdestari të gjyqtarëve në gjykatë.

-Sipas nevojës do të veprojë edhe në lëndë të tjera nga të gjitha lëmitë (lëndë civile dhe jashtëkontestimore) në të cilat për arsye të justifikuara nuk mund të veprojnë gjykatësit e tjerë në Gjykatën Themelore Dibër.

-Në lëndët penale ku gjyqtari ka vepruar në procedurë paraprake dhe për arsye të justifikueshme nuk mund të veprojë në këto lëndë, në të njëjtat do të veprojë gjykatësi Damjan Iloski.

### III.

#### **KËSHILLI PENAL (në pajtim me nen.25 parag.5 të LPP)**

Në Këshillin Penal jashtë shqyrtimit kryesor (në pajtim me nen. 25 parag.5 të LPP) përcaktohen dhe do të punojnë Kryetari i Gjykatës, gjyqtari Mersim Marku, gjyqtari Damjan Iloski dhe gjyqtari i deleguar me aktvendim të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar.

Kryetar i Këshillit do të jetë Kryetari i Gjykatës, gjyqtari Mersim Marku, ndërsa në mungesë të tij, kryetar i këshillit do të jetë gjyqtari Damjan Iloski.

Për gjyqtar në procedurë paraprake përcaktohet gjyqtari Mersim Marku, ndërsa në mungesë të tij do të veprojë gjyqtari Damjan Iloski.

## **KËSHILLI CIVIL**

Këshilli për njohjen e aktvendimeve të huaja sipas ankesës përbëhet nga gjyqtarët Damjan Iloski, Kryetar i Këshillit, Oruç Abazovski dhe një gjyqtar i deleguar.

## **IV**

Çdo gjyqtar është i obliguar të përfundojë lëndët të cilat i kanë prapambetur sipas Sistemimit të deritanishëm për Punë në Gjykatë, pa marrë parasysh llojin e lëndës dhe të jepet prioritet që të përfundohen lëndët më të vjetra se 2 vjet. Si lëndë e përfunduar në muaj do të konsiderohet vetëm ajo lëndë për të cilën vendimi është bërë me shkrim, është verifikuar në AKMIS dhe është vendosur si vendim i përfunduar, ndërsa lënda është dorëzuar në sektor më së voni deri në ditën e fundit të muajit rrjedhës.

## **V.**

### **NËPUNËSIT PROFESIONAL GJYQËSOR**

**Këshilltari gjyqësor Mevmed Muratoski**, do të punojë me Kryetarin e Gjykatës, gjyqtarin Mersim Marku dhe gjyqtarin Damjan Iloski, sipas lëndëve të të gjitha lëmive, do t'i ndjekë gjykimet në gjykatë, do t'i ndihmojë gjyqtarit gjatë studimit të lëndëve dhe në sqarimin e çështjeve të ndryshme kontestuese, si dhe në përgaditjen e materialeve të ndryshme, do të merr pjesë në mbledhjet e sektorëve gjyqësorë, merr pjesë në mbledhjet profesionale, seminare, këshillime dhe në forma të tjera të formimit profesional, do të përgadisë projektvendime, ndërsa në punën e tij do të zbatojë Rregulloren Gjyqësore dhe sistemet informativo-teknologjike ekzistuese. Do të përpilojë raportin mujor, kuartal dhe vjetor për ecurinë e lëndëve në gjykatë. I njëjti është përcaktuar si person përgjegjës për ndërmjetësimin e informacioneve të karakterit publik. Do të kryejë punë nga diapazoni i administratës gjyqësore si dhe do të kryejë punë sipas urdhërave të Kryetarit të Gjykatës. Nëpunësi gjyqësor Mevmed Muratoski për punën e tij përgjigjet në suazat e kompetencave të tij para Kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit të cili është caktuar të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë bashkëpunëtori gjyqësor Sehar Shehu.

**Bashkëpunëtori i lartë gjyqësor Hanill Bufi**, do të punojë me Kryetarin e Gjykatës sipas lëndëve në Këshillin Penal jashtë shqyrtimit kryesor dhe me gjyqtarin Oruç Abazovski sipas lëndëve nga të gjitha lëmitë. Do të merr pjesë në mbledhjet e sektorëve gjyqësor, merr pjesë në mbledhjet profesionale, seminare, këshillime dhe në forma të tjera të formimit profesional, do të përgadisë projektvendime, ndërsa në punën e tij do të zbatojë Rregulloren

Gjyqësore dhe sistemet informativo-teknologjike ekzistuese. I njëjti është caktuar si oficer për mbrojtjen e të dhënave personale, do të punojë edhe në komisione ku do të ketë nevojë për nëpunës profesional gjyqësor. Bashkëpunëtori gjyqësor Hanill Bufi përgjigjet për punën e tij në suazat e kompetencave të tij para Kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit të cili është caktuar të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë bashkëpunëtori gjyqësor Arbër Dika.

**Bashkëpunëtori i ri gjyqësor Zeqije Axhirexha**, do të punojë me Kryetarin e Gjykatës, sipas lëndëve të administratës gjyqësore – SU, SU-01, SU-02, SU-03, SU- 04, SU-05, SU-06, SU-IZZ dhe me gjyqtarin Damjan Iloski sipas lëndëve jashtëkontestimore (regjistrat: VPP, VPP1, VPP2; ODS, IPK, O, O1, ONAD, RVPP). Në rast të mungesës do ta zëvendësojë bashkëpunëtori i ri gjyqësor Sehar Shehu.

**Bashkëpunëtori i ri gjyqësor Sehar Shehu**, do të punojë me Kryetarin e Gjykatës, sipas lëndëve të administratës gjyqësore – SU, SU-01, SU-02, SU-03, SU- 04, SU-05, SU-06, SU-IZZ dhe me gjyqtarin Damjan Iloski sipas të gjitha lëndëve në të cilat vepron gjykatësi Damjan Iloski. Do të merr pjesë në mbledhjet e sektorëve gjyqësorë, merr pjesë në mbledhjet profesionale, seminare, këshillime dhe në forma të tjera të formimit profesional, do të përgadisë projektvendime, ndërsa në punën e saj do të zbatojë Rregulloren Gjyqësore dhe sistemet informativo-teknologjike ekzistuese. Bashkëpunëtori gjyqësor Sehar Shehu përgjigjet për punën e saj në suazat e kompetencave të saj para Kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit të cili është caktuar të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë bashkëpunëtori i ri gjyqësor Zeqije Axhirexha dhe këshilltari Mevmet Muratoski.

**Bashkëpunëtori i ri gjyqësor Arbër Dika**, me gjykatësin Oruç Abazovski sipas lëndëve të të gjitha lëmive. Do të merr pjesë në mbledhje të sektorëve gjyqësorë, merr pjesë në mbledhjet profesionale, seminare, këshillime dhe në forma të tjera të formimit profesional, do të përgadisë projektvendime, ndërsa në punën e saj do të zbatojë Rregulloren Gjyqësore dhe sistemet informativo-teknologjike ekzistuese. Bashkëpunëtori gjyqësor Arbër Dika përgjigjet për punën e tij në suazat e kompetencave të tij para Kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit të cili është caktuar të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë bashkëpunëtori Hanill Bufi.

## VI.

### STUKTURA ORGANIZATIVE

Në vitin 2024 puna e Gjykatës Themelore Dibër do të zhvillohet përmes këtyre sektorëve dhe shërbimeve, dhe atë, Sektorit Penal, Sektorit Civil, kontabilitet i- arka, pranimit dhe ekspeditimi i postës, dorëzimi, arkivi dhe informatika.

- Kryetar i Sektorit Penal caktohet Gjyqtari Oruç Abazovski
- Kryetar i Sektorit Civil caktohet Gjyqtari Damjan Iloski.

## VII.

Personi përgjegjës për ndërmjetësim me informacione të karakterit publik është bashkëpunëtori gjyqësor Mevmed Muratoski.

Personi zyrtar për komunikim me qytetarë të cilët kanë ndonjë lloj dhe shkallë të paaftësisë në Gjykatën Themelore Dibër është bashkëpunëtori – përkthyesi Sihana Kaba.

Oficer për mbrojtjen e të dhënave personale në gjykatë është bashkëpunëtori Hanill Bufi.

Pasi Gjykata nuk ka Sektor për Praktikë Gjyqësore, gjyqtar për praktikë gjyqësore përcaktohet gjyqtari Damjan Iloski.

## VIII.

Punët administrative-teknike në vitin 2024 do të kryhen nga ana e nëpunësve gjyqësor si vijon:

### **Pranimi dhe ekspeditimi i postës:**

**Referenti gjyqësor Burhan Fishta**, do të kryejë punët për pranimin dhe ekspeditimin e postës, pasi vendi i punës është i zbrazët për shkak të pensionimit të nëpunësit gjyqësor. Do të kryejë detyrat e punës që konsistojnë në pranimin e parashtresave, caktimin e taksës, shpërndarjen nëpër sektorë, ekspeditimin e të njëjtave, vërtetimet, si dhe punë të tjera që i takojnë si përgjegjës për pranimin e postës. Gjatë punës është i obliguar që të punojë në pajtim me Ligjin për Shërbime Gjyqësore, me Ligjin për Taksa Gjyqësore, me rregullat procedurale, procedurën e shkruar të brendshme dhe Rregulloren Gjyqësore. Në rast të mungesës së referentit gjyqësor për pranim dhe ekspeditim të postës, do ta zëvendësojë referenti i ri gjyqësor Albert Marke.

### **Nëpunësit administrativo - gjyqësor në Sektorin Penal:**

**Referenti i pavarur gjyqësor Aferdita Dema** do t'i kryejë punët administrativo-teknike të Sektorit Penal, lidhur me lëndët penale – regjistra: KPP, KNZD, K, KSP, KRP, KS-KR, KP, OU, K-POV, KUIKP, PK, IOIP, ZPD, IKP, IPK, ISAM deri në arkivimin e tyre dhe do të mbajë regjistrat elektronik, librat ndihmës në AKMIS, organizon punën dhe bën regjistrim në regjistra të veçantë në sektorin penal; kryen punë administrative në udhëheqjen e regjistrave; menaxhon me lëvizjen e lëndëve me zbatimin e sistemeve informatike- teknologjike ekzistuese; ndjek dhe zbaton rregulla dhe akte të veçanta të gjykatës për punën në zyrë dhe në arkiv; mban vulat dhe kujdeset për rruajtjen e tyre; përgadit dhe përpunon të dhëna statistikore si bazë për përgaditjen e raporteve; kryen edhe punë të tjera të vërtetuara me aktin për sistematizimin e vendeve të punës si dhe punë që do t'i besojë gjyqtari dhe kryetari i gjykatës. Gjatë punës është e obliguar të veprojë në pajtim me procedurat e brendshme të shkruara, Rregullores Gjyqësore, Ligjit për Përmbarimin e Sanksioneve. LPP, KP, me kujdes të veçantë për ndërmarrjen e masave për pagesën e taksave gjyqësore, shumave paushale dhe dënimeve në para (dërgimi i vërejtjeve

dhe kërkesave për arkëtim të dhunshëm). Gjithashtu do t'i kryejë edhe punët adminstrativo-teknike në lëndët KR (dhënia e vërtetimeve nga evidenca ndëshkuese dhe penale). Do të mbajë llogari për rregullimin dhe regjistrimin e shkresave në lëndë, ngjitjen e materialit dëshmues që pranohet jashtë shqyrtimit dhe mbajtjen me rregull të regjistrave, ashtu që në çdo moment të kqyrjes në regjistër të mund të dijë se ku ndodhet lënda dhe në cilën fazë të procedurës gjendet. Ka obligim që të udhëheqë Kontrolluesin për dënime në para, shpenzime të procedurës penale dhe shumës paushale. Në pajtim me rregullativën ligjore për ndërmarrjen e evidencës ndëshkuese në kompetenca të gjykatave është caktuar si person përgjegjës për evidencën ndëshkuese në gjykatë.

Në rast të mungesës, nëpunësin gjyqësor të cekur, do ta zëvendësojë referenti i pavarur gjyqësor Areta Pekmezi.

**Referenti i lartë gjyqësor Rakip Karpuzi** do të udhëheqë regjistrat sipas lëndëve kundërvajtëse (PRK-J, PRK-S, PRK-O, PRK –R, PRK-POV, KS-PRK, ZPD, IPRK) dhe do të kryejë punët adminstrativo-teknike të të gjitha lëndëve kundërvajtëse, deri në arkivimin e tyre dhe do të mbajë regjistrat elektronik dhe librat ndihmës në AKMIS. Gjatë punës është i obliguar të veprojë në pajtim me procedurat e brendshme të shkruara, Rregullores Gjyqësore, Ligjit për Përmbarimin e Kundërvajtjeve, me kujdes të veçantë për ndërmarrjen e masave për pagesën e taksave gjyqësore, shumave paushale dhe dënimeve në para (dërgimi i vërejtjeve dhe kërkesave për arkëtim të dhunshëm). Gjithashtu, veçanërisht do të mbajë llogari për rregullimin dhe regjistrimin e shkresave në lëndë, ngjitjen e materialit dëshmues që pranohet jashtë shqyrtimit dhe mbajtjen me rregull të regjistrave, ashtu që në çdo moment të kqyrjes në regjistër të mund të dijë se ku ndodhet lënda dhe në cilën fazë të procedurës gjendet. Në rast të mungesës, do ta zëvendësojë referenti gjyqësor Albert Marke.

**Referenti i lartë gjyqësor Albert Marke** do të udhëheqë regjistrin për lëndë të ndryshme penale KR, KS-KR – dhënie e vërtetimeve nga evidenca penale dhe ndëshkuese, do të kryejë punët adminstrativo-teknike të të gjitha lëndëve të përmendura, deri në arkivimin e tyre dhe do të mbajë regjistrat elektronik dhe librat ndihmës në AKMIS. Gjatë punës është i obliguar të veprojë në pajtim me procedurat e brendshme të shkruara, Rregullores Gjyqësore, Ligjit për Përmbarimin e Kundërvajtjeve, me kujdes të veçantë për ndërmarrjen e masave për arkëtimin e taksave gjyqësore, shumave paushale dhe gjobave (dërgimi i vërejtjeve dhe kërkesave për arkëtim të dhunshëm). Gjithashtu, do të mbajë llogari për regjistrimin dhe e shkresave në lëndë, ngjitjen e materialit dëshmues që pranohet jashtë shqyrtimit dhe mbajtjen me rregull të regjistrave, ashtu që në çdo moment të kqyrjes në regjistër të mund të dijë se ku ndodhet lënda dhe në cilën fazë të procedurës gjendet. Do t'i kryejë punët lidhur me Komisionin e Prokurimeve Publike pranë gjykatës. Në rast të mungesës do ta zëvendësojë referenti i lartë gjyqësor Rakip Karpuzi, dhe të veprojë në të gjithë regjistrat që vepron referenti Rakip Karpuzi.

### **Nëpunësit admistrativo gjyqësor në Sektorin Civil.**

**Referenti i pavarur gjyqësor Areta Pekmezi** do të udhëheqë regjistrat dhe do të kryejë punët adminstrativo-teknike në Sektorin Civil të të gjitha lëndëve kontestuese (regjistri P1, P2, P3, P4, P5, RO, PL1P, MALBP,RO POV, PLPOV, RP, RRO, IZS), deri në arkivimin e tyre dhe

do të mbajë regjistrat e tyre elektronik dhe librat ndihmës në AKMIS, në pajtim me procedurat e brendshme të shkruara, Rregullores Gjyqësore, me kujdes të veçantë për ndërmarrjen e masave për pagesën e taksave gjyqësore, dënimeve të shqiptuara në para në pajtim me LPK (dërgimi i vërejtjeve dhe kërkesave për arkëtim të dhunshëm). Gjithashtu, veçanërisht do të mbajë llogari për rregullimin dhe regjistrimin e shkresave në lëndë, ngjitjen e materialit dëshmues që pranohet jashtë shqyrtimit dhe mbajtjes me rregull të regjistrave, ashtu që në çdo moment të kqyrjes në regjistër të mund të dijë se ku ndodhet lënda dhe në cilën fazë të procedurës gjendet. Në rast të mungesës së nëpunësit gjyqësor të përmendur do ta zëvendësojë referenti i pavarur gjyqësor Afërdita Dema.

**Referenti gjyqësor Burhan Fishta** do të udhëheqë regjistrat dhe do të kryejë punët adminstrativo-teknike në Sektorin Civil të të gjitha lëndëve jashtëkontestuese (regjistri VPP, VPP1, VPP2, ODS, IPK, O, O1, ONAD; RVPP), deri në arkivimin e tyre dhe do të mbajë regjistrat e tyre elektronik dhe librat ndihmës në AKMIS, në pajtim me procedurat e brendshme të shkruara, Rregullores Gjyqësore, me kujdes të veçantë për ndërmarrjen e masave për pagesën e taksave gjyqësore, dënimeve të shqiptuara në para në pajtim me LPK (dërgimi i vërejtjeve dhe kërkesave për arkëtim të dhunshëm). Gjithashtu, veçanërisht do të mbajë llogari për rregullimin dhe regjistrimin e shkresave në lëndë, ngjitjen e materialit dëshmues që pranohet jashtë shqyrtimit dhe mbajtjes me rregull të regjistrave, ashtu që në çdo moment të kqyrjes në regjistër të mund të dijë se ku ndodhet lënda dhe në cilën fazë të procedurës gjendet. Në rast të mungesës së nëpunësit gjyqësor të përmendur do ta zëvendësojë referenti i lartë gjyqësor Albiona Daci.

## IX.

### **Referentët gjyqësor (daktilografë- procesverbalistë)**

Referentët gjyqësor (daktilografë- procesverbalistë) në vitin 2024 do të punojnë në lëndë me gjyqtarët sipas sistemimit vijues:

**Referenti gjyqësor (daktilografe-procesverbaliste) Burbuqe Çanka**, do të punojë me gjyqtarin Oruç Abazovski. Do t'i krejë punë në kompetencat e referentit-procesverbalistit. Për punën e vet përgjigjet para gjyqtarit te i cili është sistemuar që të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë Sllagjana Siljanoska.

**Referenti gjyqësor (daktilografe-procesverbaliste) Sllagjana Siljanoska**, do të punojë me gjyqtarin Damjan Iloskii. Do t'i krejë punë në kompetencat e referentit-procesverbalistit. Për punën e vet përgjigjet para gjyqtarit te i cili është sistemuar që të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë Burbuqe Çanka.

**Referenti gjyqësor (daktilografe-procesverbaliste) Fetije Jonuzi**, do të punojë me Kryetarin e Gjykatës, gjyqtarin Mersim Marku. Do t'i krejë punë në kompetencat e referentit-procesverbalistit. Për punën e vet përgjigjet para gjyqtarit te i cili është sistemuar që të punojë. Në rast mungese do ta zëvendësojë bashkëpunëtori i ri Zeqije Axhiresha.



**Referenti i lartë gjyqësor (arkiviste) Samirije Marke** vepron sipas lëndëve të përfunduara të cilat duhet të ruhen në arkivat e gjykatës, në mënyrë kronologjike të rregullon lëndët në arkivat, në punën me lëndët e zbaton Rregulloren Gjyqësore dhe aktet e gjykatës, zbaton rregullat dhe aktet e gjykatës për punë me arkiv, punon me vulat dhe shtembilet dhe kujdeset për të njëjtat; me kërkesës të kryetarit të gjykatës, kryetarit të sektorit dhe gjykatësit jep lëndët e arkivuara, kryen edhe punë të tjera të që ia beson nëpunësi gjyqësor epror i drejtëpërdrejtë dhe kryetari i gjykatës.

Për punën e vet përgjigjet para kryetarit të gjykatës.

**Referenti i pavarur gjyqësor kontabiliste - arkëtare Mirela Çutra** do të udhëheqë kontabilitetin dhe thesarin e gjykatës, në pajtim me rregullat për punë materiale-financiare, si dhe do të punojë në sistemin elektronik ABMS, do t'i kryejë punët e thesarit, dhe atë me rregull, në kohën e duhur dhe në mënyrë azhure, në pajtim me rregullat për punë me thesarin dhe me Rregulloren Gjyqësore. Për shkak të evidentimit të lëndëve dhe mjeteve nga depozita, arkëtari, përveç punëve të zakonshme të thesarit është e obliguar të udhëheqë edhe: raportin e thesarit, për pranimin dhe lëshimin e depozitave – mjete në para të gatshme, ditarin për depozita të përkohëshme dhe të rregullta, ditarin për depozita pa para të gatshme të cilat ruhen në thesarin e gjykatës dhe ditarin për depozita pa para të gatshme të cilat ruhen te organet e tjera. Gjatë punës është e obliguar të veprojë në pajtim me rregullat nga lëmia e financave. Në rast të mungesës do ta zëvendësojë nëpunësi gjyqësor – këshilltari informaticient Patriot Papraniku.

**Këshilltari – Informaticienti Patriot Papraniku**, do të kryejë kontrollimin e punës së sistemeve informatike dhe të menaxhojë me funksionimin e pajisjeve informatike dhe përdorimin e sistemit të kompjuterizuar automatik për menaxhimin me lëndët gjyqësore (AKMIS), të zbatojë masa të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave nga ky softuer, t'ju ndihmojë të punësuarve për përdorimin e sistemit për regjistrimin zanor të seancave dhe për kryerjen e dorëzimit elektronik të shkresave, t'i ndjekë të gjitha avancimet dhe versionet e reja të AKMIS-it dhe nëse është e nevojshme të mbajë trajnime për të njëjtat. Një punë tjetër për këshilltarin – informaticient është që vendimet e pranuar të anonimizuara të gjyqtarëve menjëherë t'i publikojë në Veb-faqen e gjykatës dhe të mirëmbajë tërësisht VEB-faqen e portalit gjyqësor.

**Bashkëpunëtori - përkthyesi Sihana Kaba** do të bëjë përkthimin e shkresave në Gjykatë nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, sipas nevojës do të bëjë përkthim dhe interpretim të palëve gjatë shqyrtimeve. Bashkëpunëtori i emëruar interpretues caktohet si person përgjegjës për komunikim me palët me aftësi të kufizuar.

Në rast mungese të përkthyesit, Gjykata do të sigurojë zëvendësim nga lista e përkthyesve gjyqësor nga gjuha shqipe në atë maqedone dhe anasjelltas dhe atë nga territori i gjykatës.

**Referentët e ri gjyqësor – dorëzuesit: Xhevdet Marke dhe Zudi Islamovski**, janë të obliguar që dorëzimin e shkresave të gjykatës ta kryejnë me ndërgjegje dhe përgjegjësi, në mënyrë të rregullt dhe azhure, në pajtim me rregullat ligjore, si dhe çdo ditë të mbajnë evidencë të saktë për ngarkimin dhe shkarkimin me shkresat.

Dorëzuesi Xhevdet Marke do të kryejë dorëzimin e shkresave te palët në teritorin e qytetit të Dibrës, ndërsa dorëzuesi Zudi Islamovski do të kryejë dorëzimin e shkresave te palët persona juridikë në teritorin e qytetit dhe te palët në vendet e banuara pranë komunave Dibër dhe Qendër Zhupë, përveç në fshatrat Xhepishte, Otishan dhe Dolgash.

Përveç punëve të lartpërmendura, dorëzuesit gjyqësor do të kryejnë dhe punë të tjera në pajtim me kualifikimin dhe arsimin e tyre, me urdhër të Kryetarit të Gjykatës.

## X.

### **POLICIA GJYQËSORE:**

Pjesëmarrësit e Policisë Gjyqësore në përbërje: Arber Karpuzi, Rexhep Pocesta, Naser Sela dhe Mesut Rasimovski do të kryejnë në mënyrë të vazhdueshme (24 orë) sigurimin dhe mbrojtjen e ndërtesës së gjykatës, pronës dhe personave dhe do të mbajnë rregull në gjykatë, duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme, në pajtim me rregullat ligjore të cilat e regullojnë veprimtarinë e pjesëmarrësve të policisë gjyqësore. Gjatë punës kanë obligim që t'i përmbahen orarit të punës së tyre, ndërsa mes veti mund të zëvendësohen vetëm me miratim të kryetarit të gjykatës.

Pjesëmarrësit e policisë gjyqësore, në rast të nevojës do të ndërmarrin veprime për kryerjen normale të punëve dhe detyrave jo vetëm në ndërtesën e gjykatës.

## XI.

### **Mbajtja e higjienës në ndërtesën e gjykatës**

Pasiqë punëtorit të mbajtjes së higjienës së ndërtesës së gjykatës iu ndërpre marrëdhënia e punës në kohë të caktuar me datë 31.12.2023, deri në plotësimin e vendit të punës me kryerës higjienist, mbajtjen e higjienës në ambientet e punës dhe përreth gjykatës do ta kryejë një kryerës i angazhuar me kontratë në vepër.

## XII.

Në pajtim me Rregulloren Gjyqësore, për sigurimin e një numri më të madh të publikut, gjykimet do të mbahen vetëm në sallat e gjykimit ashtu që sallën e gjykimit II e cila është e pajisur me regjistrim zanor do ta shfrytëzojnë të gjithë gjyqtarët për shkak të regjistrimit zanor të shqyrtimeve.

Gjykatësit gjatë gjykimit janë të detyruar që të mbajnë togë (nen. 57 të Ligjit për Gjykata).

## XIII

Si ditë e pranimi të palëve te Kryetari i Gjykatës caktohet çdo ditë e mërkurë në periudhën prej orës 09:00 deri në orën 12:00.

Dita e pranimi për palët në sektorët e gjykatës dhe në shkrestarinë gjyqësore përcaktohet çdo ditë e javës në periudhën nga ora 8:00 deri më orën 15:00.

#### **XIV**

Çdo të hanë të parë gjatë muajit në orën 08:30 do të mbahet mbledhja e gjyqtarëve, ndërsa në orën 14:30 do të mbahet mbledhje me të gjithë të punësuarit në gjykatë.

**KRYETARI I GJYKATËS  
MERSIM MARKU**

#### **Dorëzime:**

- Të gjithë gjykatësve, nëpunësve gjyqësorë dhe policisë gjyqësore.

#### **URDHËR:**

**DETYROHET** nëpunësi gjyqësor-informaticienti Patriot Papraniku që këtë sistemim vjetor ta realizojë në sistemin AKMIS dhe me postë elektronike ta dërgojë te gjykatësit dhe të punësuarit në gjykatë dhe ta shpallë në veb faqen e Gjykatës Themelore Dibër.

**KRYETARI I GJYKATËS  
MERSIM MARKU**